

VENDIM
Nr. 756, datë 12.11.2014

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E INTEGRIMIT EVROPIAN, PËR PËRBALLIMIN E TVSH-së, NË
KUADËR TË PROJEKTIT “GREEN BOAT”, FINANCUAR NGA BASHKIMI
EVROPIAN NËPËRMJET FONDEVE IPA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr., 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Integrimit Evropian, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Mbështetje institucionale për procesin e integrimit”, zëri “Shpenzime kapitale, kapitulli 04 (TVSH)” t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 29 300 (njëzet e nëntë mijë e treqind) eurosh, për përballimin e kostos së TVSH-së për projektin “Green Boat”, të financuar nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet fondeve IPA, program i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, me përfitues Komunën Pustec.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2014.

3. Ngarkohet Ministria e Integrimit Evropian për përgatitjen e dokumentacionit të akordimit dhe transferimit të shumës përkatëse Komunës Pustec, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama